



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.5.2023

Nr: 516

Ora: 18:00

VENDIM

PËR

**HEQJEN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE NGA TË GJITHA  
EKRANET LED WALL NË AFËRSI TË QV-VE, KZAZ-VE DHE VNV-VE**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “p”, “n”, dhe 2, si dhe të udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Heqjen e menjëhershme të të gjitha materialeve propagandistike të subjekteve zgjedhore nga të gjitha ekranet LED Wall në distancë më të vogël se 300 metra nga selitë e QV-ve, KZAZ-ve dhe VNV-ve.
2. Ngarkohen subjektet zgjedhore, Policia e Shtetit dhe policitë bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim do ju njoftohet subjekteve zgjedhore, Policisë së Shtetit si dhe Policive Bashkiake nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 13.5.2023 Nr: 516  
Ora: 18:00



“Për heqjen e materialeve propagandistike të subjekteve zgjedhore nga të gjitha ekranet LED Wall në afërsi të QV-ve, KZAZ-ve dhe VNV-ve”